



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:228971

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05544035

Në çështjen juridike të :

AC-I-22-0634-A0001

Paditëse

H H fshati K, Viti.

Kundër:

E

paditura/Ankuesja

N.SH. “Letnica” (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-0525, të datës 4 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 4 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet, Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-0525, i datës 4 tetor 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 11 prill 2013, paditësja kishte parashtruar një kërkesë për rishikimin e vendimit të Autoriteti të Likuidimit me nr. GJI083-0045 të datës 14 mars 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditëses për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 613.55 euro ishte refuzuar si e pavlefshme. Kjo për faktin se nga lista e pagave për 12 muajt e fundit para datës së nënshkrimit të kontratës së privatizimit të paraqitur nga menaxhmenti i ndërmarrjes shoqërore nuk pasqyron ndonjë pagesë të kryer ndaj parashtruesit të kërkesës. AL kishte vërejtur se parashtruesja e kërkesës nuk kishte punuar pra nuk ka qenë punëtoare aktive e N.SH-së kur u privatizua kjo e fundit.

Në kërkesë theksohet se paditësja ka qenë e punësuar për kohë të pacaktuar të NSH “Letnica” dhe asnjëherë nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punë derisa AKP me letër pezullim të datës 12 qershor 2009 për shkak të shitjeve të asetëve të N.SH-së e kishte njoftuar se është vendosur që të njëjtit t’ia përfundoj marrëdhënien e punës për shkak të tepricës dhe se ky përfundim i punës ka efekt të menjëhershëm. Me fillimin e procedurës së likuidimit i njëjti kishte paraqitur kërkesë me shkrim për kompensimin për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës duke plotësuar formularin për parashtrimin e kërkesës për likuidim që është pranuar në AKM. Andaj, kishte propozuar që të aprovohet kërkesa e tij ose të priset vendimi i AL-së dhe lënda t’i kthehet AKP-së për rishqyrtim dhe rivendosje.

Kërkesës i kishte bashkëngjitur këto prova: kontratën e punës të datës 20 tetor 2001 ndërmjet N.SH-së dhe paditëses, formularin për parashtrimin e kërkesës në likuidim të datës 11 janar 2011, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI083-0045 të datës 14 mars 2013, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 12 qershor 2009 si dhe kopjen e librezës së punës së paditëses.

Me datë 16 shtator 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën theksohet se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktë. Pala kundërshtare mban qëndrimin se marrëdhënia e punës i është ndërprerë në momentin kur parashtruesi rreshti së punuari për N.SH-në dhe nuk kishte marrë më rrogë prej saj. Letra në fjalë nuk mund t’i jepte fund një marrëdhënie pune që tashmë ishte e përfunduar më parë. Në rastin konkret parashtruesi kishte pretenduar që ka punuar pranë N.SH-së deri në vitin 2009, mirëpo pala kundërshtare e konteston një pohim të

tillë dhe vëren se parashtruesi nuk ka dhënë asnjë përshkrim të punës/funksionit konkret që ka kryer në N.SH gjatë periudhës 12 mujore që parapriu privatizimin. Andaj, kishte propozuar që ankesa e paditëses të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur një kërkesë për emërim të anëtarëve në Autoritetin e Likuidimit, regjistrin e punëtorëve mbi pagimin e pagave për muajin maj të vitit 2009, llogaria totale e pagave të papaguara për muajt janar-dhjetor 2008 si dhe llogaria totale mbi pagat e papaguara për periudhën nga 1 janar 2009 deri më 11 qershor 2009.

Me datë 4 tetor 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimi C-IV-13-0525 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e paditëses duke obliguar AKP-në që t'ia paguaj paditëses në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës shumë prej 613.55 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se gjykata gjen se është fakt i pa kontestuar se ankuesja ka punuar për N.SH nga marsi 1993-qershor 2009, që nënkupton se gjykata ka mundur të merr parasysh kur e llogarit periudhën e punësimit e cila e përcakton shumën e parave që duhet të paguhet si dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të punës, periudhën prej vitit 1993 deri 2009, nga çka kuptohet se përvoja e plotë e punës së ankuses është për 13 vite e 2 muaj. Autoriteti i Likuidimit nuk e kishte arsyetuar me prova bindëse faktin se parashtruesja e kërkesës nuk ka punuar, pra nuk ka qenë punëtorë aktive e N.SH-së kur është privatizuar kjo e fundit. Në anën tjetër e njëjta ka dorëzuar Letër Pezullimin e lëshuar nga vet Agjencia të datës 12 qershor 2009.

Me datë 18 nëntor 2022, AKP-ja kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-13-0525 të datës 4 tetor 2022, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke refuzuar ankesën e paditëses ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe duke vërtetuar këtë të fundit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë dy afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Duke injoruar plotësisht parashtresën e palës kundërshtare dhe argumentet e saj në mbrojtje, Aktvendimi nuk përmbushë aspak detyrimin e shprehur në

nenin 54 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtrësive të prezantuara gjatë procedurës. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI083-0045 të datës 14 mars 2013 si dhe një vendim për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 1 nëntor 2022.

Me datë 1 shkurt 2023, paditësja kishte paraqitur përgjigje në ankesë në të cilën i propozon Kolegjit të Apelit që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i DHPGJS-së.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditëses për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 613.55 euro ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se sipas të dhënave të Autoritetit të Likuidimit, e njëjta nuk kishte punuar, pra nuk ka qenë punëtore aktive e N.SH-së kur u privatizua kjo e fundit.

Paditësja në ankesën e saj të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI083-0045 të datës 14 mars 2013, kishte bashkëngjitur provat si në vijim: kontratën e punës të datës 20 tetor 2001 ndërmjet N.SH-së dhe paditëses, formularin për parashtrimin e kërkesës në likuidim të datës 11 janar 2011, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI083-0045 të datës 14 mars 2013, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 12 qershor 2009 si dhe kopjen e Librezës së punës së paditëses.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditëses të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 613.55 euro me arsyetimin kompensim të tre pagave të papaguara në shumën prej 892.10 euro me arsyetimin se e njëjta kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditëses.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga kopja e Librezës së punës së paditëses e dorëzuar si provë nga e njëjta shihet se e njëjta kishte ofruar shërbime për N.SH deri në ditën e privatizimit të saj.

Gjithashtu, nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditëses i datës 12 qershor 2009, i cili është i bashkëngjitur në prova në shkresa të lëndës, shihet që paditëses i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, pra me 12 qershor 2009. Ky njoftim në përmbajtjen e tij thekson se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*.

Andaj, e njëjta duke u përmbajtur udhëzimeve të lartcekura e kishte dorëzuar kërkesën e saj, brenda afatit të caktuar ligjor, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 613.55 euro.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument ligjor sipas nenit 42.2 të Ligjit për DHOGJS-ne me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësja, pra për të vërtetuar faktin se paditësja nuk kishte ofruar shërbime punë për N.SH apo se nuk i takon dëmshpërblimi i lartcekur.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditëses i ka njohur të drejtën në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 613.55 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 4 prill 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
